

VENDIM
Nr.1477, datë 12.11.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”,
NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME
TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET
SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I “Mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm”, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “f” të pikës 1, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) Të punësuarit, që punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si punëtorë shtëpie, në familjet e të tjerëve, sigurohen në mënyrë të detyrueshme vetëm për degën e pensioneve. Punëtorë shtëpie janë personat, që punësohen nga kryefamiljari, në punë të tilla, si kujdestar për fëmijët, kuzhinier, pastrues, rojë-administrator shtëpie, asistent për të moshuarit etj., apo dhe në shërbime të ndryshme, të kësaj natyre.”.

b) Pas paragrafit të parë të pikës 3, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punëtorët e punësuar për herë të parë në një profesion të caktuar, në subjekte, që punojnë me material porositësi (*fason*), për kohën e programuar të formimit profesional, për të kryer punë të kualifikuara, në rastet kur punëdhënësi nuk përfiton financime nga zyra përkatëse e punësimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit profesional”, sigurohen vetëm për aksidente dhe sëmundje profesionale.”.

2. Pas pikës 12 të kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, shtohen pikat 13 e 14, me këtë përmbajtje:

“13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore, për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, sipas përcaktimit në shkronjën “g” të pikës 1 të këtij vendimi, të jetë 1 000 (një mijë) lekë/muaj.

14. Kontributi i detyrueshëm për aksidente dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit profesional të personave të punësuar në subjekte, që punojnë me material të porositësit, të jetë 0.5 për qind e pagës bruto minimale, dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.”.

3. Pas pikës 7 të kreut IV “Procedurat për regjistrim”, shtohen pikat 8 e 9, me këtë përmbajtje:

“8. Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, i lidhin marrëveshjet e punës përmes një marrëveshjeje, me shkrim, ndërmjet palëve, ku, përveç të tjerave, shënohen, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror i personit të punësuar, koha e fillimit të punës dhe zgjatja e saj, “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe, si i tillë, ka detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Regjistrimi dhe procedurat e pajisjes me numër siguri, si për rastin kur i punësuar shërben në një familje apo në më shumë se një familje, bëhet sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet nga Ministri i Financave.

9. Formimi profesional nëpërmjet punës, për kualifikimin e punëmarrësit në një profesion të caktuar, të domosdoshëm për veprimtarinë ekonomike, realizohet nga punëdhënësi. Pjesëmarrja në trajnim, në rastet kur është parashikuar vetëm siguri për degën e aksidentit në punë, lejohet vetëm

një herë dhe jo më shumë se një muaj, për një person. Koha e programuar e formimit profesional nëpërmjet punës, lloji i kualifikimit dhe lista e personave pjesëmarrës deklarohen zyrtarisht në zyrën përkatëse të punësimit, përpara fillimit të trajnimit.”.

4. Pas pikës 9 të kreut V “Pagesa e kontributeve” shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas këtij vendimi, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, paguhen nga kryefamiljari, i përcaktuar si punëdhënës, në llogaritë bankare, të përcaktuara sipas procedurave, të vendosura për këtë qëllim. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, sipas rregullave për pagesat e kontributeve nga personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël. Këta persona, sikurse dhe personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbim, ambulante, pajisen me librezën e kontributit, nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyruara ta plotësojnë në vijimësi, në bazë të kontributeve të paguara, dhe vlerësohen të siguruar, për efekt mbrojtjeje nga sigurimet shoqërore, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës. Në këtë rast në librezë shënohet “Të siguruar vetëm për pension”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha